




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË
SHOQËRIA PËRMBARIMORE "616/A"- SH.P.K**



Nr. 191/6 Prot

Pogradec më 20.08.2018

**URDHËR
"PËR VËNIEN E SEKUESTROS KONSERVATIVE"**

Drejtuar: Qendra Kombëtare e Biznesit, QKB .

Për dijëni Debitorit: P.F. "Mimoza Zambaku", me NIPT – L12808202B

Mimoza Xhavit Zambaku, me datëlindje 21.09.1966.

Adresa : L. "5 Maj", Rr. "Shpëtim Arapi", Pall nr.580/16, hyrja C/ hyrja e fundit, k. 1, Elbasan.

Në Rregjistrin e Titujve ekzekutiv të zyrës së Shoqërisë Përmbaarimore 616/A sh.p.k, me kërkesë të palës kreditore më datën 19.07.2018, është rregjistruar çështja përmbaarimore me numur 191 regjistri me palë :

Kreditor : Shoqëria "LA-trend" sh.p.k.

Debitor : P.F. "Mimoza Zambaku".

Me objekt : Kthim shume.

Unë përmbaruesi gjyqësor Erzen Qeva, pasi shqyrtova materjalin e plotë të dosjes përmbaarimore :

KONSTATOVA :

Në titullin ekzekutiv, vendimi me Nr.316 (1298), datë 02.03.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është vendosur detyrimi i debitorit P.F. "Mimoza Zambaku", ti paguajë detyrimin në shumën prej 383.040 lekë, dhe shpenzimet gjyqësore në vlerën 120.000 lekë, në total detyrim në vlerën 503.040 lekë në favor të kreditorit Shoqëria "LA-trend" sh.p.k plus pagimin e tarifës të shërbimit përmbaarimor në vlerën 60.365 lekë, me TVSH.

Në total detyroheni të paguani shumën 563.405 (Pesëqind e gjashtëdhjet e tre mijë e katërqind e pesë) lekë.

Ky titull ekzekutiv në bazë të ligjit Nr. 38/2017, datë 30.3.2017, nenit 511/b, sipas paragrafit të fundit të dispozitivit të titullit është I ekzekutueshëm nga përmbaruesi gjyqësor.

Në datën 15.08.2018, në bazë të nenit 519 të K.Pr.Civile nga ana jonë, është marrë vendimi i kalimit të ekzekutimit në ekzekutim të detyrueshëm dhe në këto kushte në vazhdim të veprimeve përmbaarimore kërkohet të vendoset masa e sekuestros në kuotat/aksionet e palës debitore, Mimoza Zambaku, person fizik me NUIS (NIPT) L12808202B, dhe në Shoqërinë "BEKIM 009 & M" sh.p.k, me NUIS (NIPT) L83111202T, si dhe mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrimit tregtar .

Për këtë arsye : Në bazë të neneve 527 e në vijim të K.Pr.Civile .

URDHËROJMË:

1-Vendosjen e masës së sekuestros konservative mbi kuotat/aksionet, e palës debitore **Mimoza Xhavit Zambaku**, tek Personi Fizik "**Mimoza Zambaku**", me NIPT – L12808202B, me

përfaqësues ligjor administrator Znj. Mimoza Xhavit Zambaku, dhe Shoqëria "BEKIM 009 & M" sh.p.k, me NUIS (NIPT) L83111202T, me përfaqësues ligjor administrator Znj. Mimoza Xhavit Zambaku dhe ortak Bekim Mehmeti, me Seli Elbasan, për shlyerjen e detyrimit në shumën 563.405 lekë.

2- Mbi të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i këtyre kuotave duke ndaluar tjetërsimin dhe/ose disponimin e tyre si dhe mos kryerjen e asnjë veprimi tjetër i cili mund të ndryshojë të dhënat e regjistrit tregtar. Dokumentacioni do të qendrojë i bllokuar deri në një urdhër të dytë nga ana jonë.

3-Për veprimin apo mosveprimin tuaj, duhet të na vini në dijeni shkresërisht brenda afatit ligjor.

4-Për personat që bëhen pengesë në zbatimin e këtij urdhëri do të merren të gjitha masat e parashikuara në neni 606 e në vijim të K.Pr.Civile, si dhe në rast se ka vend do të kërkohet ndjekje penale në bazë të dispozitave të Kodit Penal.

5-Ky urdhër mbahet e ju njoftohet palëve të cilat në baze të nenit 610 të K.Pr.C kanë të drejtën e ankimit në gjykatën e rrethit gjyqësor brenda 5 ditëve nga marja e dënimit.

**SHOQËRIA PËRMBARIMORE "616/A" SHPK
PËRMBARUESI GJYQËSOR**

Erzen QEVA

